

# TA PËRSHPEJTOJMË BARAZINË GJINORE

MANUAL PËR MËSUESIT E SHKOLLËS  
FILLORE DHE TË MESME

# TA PËRSHPEJTOJMË BARAZINË GJINORE

manual për mësuesit e shkollës fillore dhe të mesme

## **Botuesi:**

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)



Centar za građansko obrazovanje  
Centre for Civic Education

## **Redaktore:**

Maja Marinović

## **Pergatitur nga:**

Svetlana Jovetić Koprivica dhe Miroslav Minić

## **Produksioni:**

Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ)

## **Përkthimi në gjuhën shqipe:**

Monika Mrnjaçević dhe Nikolla Gjonović

*Publikimi është pjesë e projektit "TA PËRSHPEJTOJMË barazinë gjinore (faza II) - nga stereotipizimi në barazi!" të cilin Qendra për Arsimim Qytetar (QAQ) e zbaton me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave të Qeverisë së Malit të Zi.*

*Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e QAQ dhe autorëve.*

# **TA PËRSHPEJTOJMË BARAZINË GJINORE**

MANUAL PËR MËSUESIT E SHKOLLËS FILLORE DHE TË MESME

Podgoricë, 2022.

# Përmbajtja

Barazia nuk mund të presë .....	<b>5</b>
Hyrje .....	<b>7</b>
1. Punëtori – Dalloj seksin dhe gjininë .....	<b>9</b>
2. Punëtori – Rolet gjinore .....	<b>11</b>
3. Punëtori – Stereotipet .....	<b>13</b>
4. Punëtori – Stereotipet në përralla .....	<b>15</b>
5. Punëtori – Diskriminimi gjinor .....	<b>17</b>
6. Punëtori – Ta njoftojmë seksizmin .....	<b>19</b>
7. Punëtori – Dhuna ndaj grave dhe femicidi .....	<b>22</b>
8. Punëtori – Patriarkati dhe mizogjia .....	<b>24</b>
9. Punëtori – Gjuha dhe seksi .....	<b>26</b>
10. Punëtori – Barazi për të gjithë, kudo dhe gjithmonë .....	<b>29</b>

# Barazia nuk mund të presë

Në vend të adresimit të zakonshëm për mësuesit dhe mësueset e këtij manuali të thjeshtë, vendosëm të ndajmë me ju një anekdotë interesante nga jeta profesionale.

Është viti 2021 muaji Mars. Me ftesë të koleges që është e punësuar në një shkollë në Podgoricë, shkuam në një ligjëratë një orëshe ku duhej të promovojmë rëndësinë e edukimit mediatik në arsim. Mbase kjo është një temë që trajtojmë intensivisht, të frymëzuar kaluam nëpër korridorin e shkollës të ndriçuar në ngjyrë të verdhë të ndritshme. Na përshëndet asistentja e drejtorit. Me dashamirësi na fton të bëjmë një pushim të shkurtër përpara se të fillojë ora. Mirënjohës për pritjen e këndshme dhe të emocionuar për takimin me të rinj me synim t'i motivojmë të zgjedhin shkrim-leximin mediatik si lëndë zgjedhëse, kërkojmë që të na drejtojnë në klasën ku na pret kolegja dhe nxënësit. Asistentja e drejtorit na ndjek dhe na pyet pa ndërhyrë nëse mund të marrë pjesë edhe ajo sepse i interesojnë temat që kanë të bëjnë me shkrim-leximin mediatik. Na inkujaron dëshira e saj dhe e ftojmë të na bashkohet.

Hyjmë në klasë të gjërë, të pajisur me mjete të përshtatshme mësimore dhe teknike. Në secilin prej rreth njëzet stolave ulen nga dy djem të moshës 15 deri 18 vjeç. Me ta është edhe mësuesja e gjuhës dhe letërsisë, e cila i mblodhi dhe u shpjegoi se për çfarë do të flasim. Të rinjve iu duket interesante, dëgjojnë në mënyrë aktive dhe drejtpërdrejt ndajnë përvojat e tyre me ne. Gëzimi është i dukshëm në fytyrat tona për shkak të interesit që shfaqin për tema të rëndësishme të dekonstruktimit të mesazheve mediatike, respektimin e kodit të gazetarëve, pranisë së gjuhës së urrejtjes në rrjetet sociale e të tjera. Një nga temat është gjuha e medias e ndjeshme ndaj gjinisë.

Asistentja e drejtorit merr fjalën dhe shpjegon – *Nuk më pëlqen shumë kur nxënësit më drejtohen si “zavëndese”. Unë nuk jam as mbiemër, as folje, as përemër - jam zavëndës, ndihmëse e drejtorit.* Duke tundur kokën pozitivisht, profesorja shton – *Nuk i lejoj nxënësit të më drejtohen si mësuese, unë jam profesor!* Nxënësit lëvizin pa fjalë mjekrën lart e poshtë dhe miratojnë qëndrimin e mësueses.

Pa dëshirë të veprojmë me kritika agresive, dhe me synimin për të ndërgjegjësuar së bashku besime të tilla, e pyesim nxënësin në bankën e tretë:

– *Si e ke emrin?*

- *Unë jam Nikolla.*

- *Nikolla, a do të ndihëshe mirë sikur të hyja çdo ditë në klasë dhe të thoja - Nikolla, ti je një studente shumë e përkushtuar që merr njohuritë bazë. Ose, ti je nxënëse me të cilën jam e lumtur që bashkëpunoj. Ose, më duket se sot nuk je veçanërisht e frymëzuar për të punuar. Ose, nxënëse si ndihesh sot? - Prezantimi shoqërohet me një nënqeshje të lehtë nga nxënësit e tjerë.*

- *Nuk do të isha rehat. Unë jam mashkull. Unë jam nxënës.*

- *Gjithashtu, nuk është e këndshme kur profesoreshës i drejtohem si profesor, gjyqtarës si gjykatës, mjekës si doktor ose çfarë do profesioni në gjininë mashkullore kur e kryen gruaja.*

“Efekti aha” dhe momenti kur ata arrijnë të kuptojnë se përse është e rëndësishme të përdoret gjuha me ndjeshmëri gjinore bëhet befasi i dukshëm në fytyrat e nxënësve, kolegës tonë dhe asistentes së drejtorit.

Kolegja shpjegon në detaje përse është e nevojshme të shmangen stereotipet dhe se si gjuha ka një konotacion dhe potencial të fortë për të ndikuar në shoqërinë tonë, e cila tradicionalisht favorizon diskriminimin pozitiv ndaj burrave, pra diskriminimin negativ ndaj grave.

Duke ndarë këtë anekdotë me ju, ju ftojme të merrni pjesë gjatë orës së mësimit dhe me qendrim, ide, opinion dhe veprim tuaj të kontribuoni për barazi, barazinë gjinore dhe përfundimisht luftën kundër dhunës ndaj grave.

Svetllana Jovetiç Koprivica, **profesoreshë**  
e gjuhes dhe letërsisë malazeze - serbe, boshnjake, kroate / Shkrim-leximi Mediatik

Mirosllav Miniç, **profesor**  
i gjuhes dhe letërsisë malazeze - serbe, boshnjake, kroate / Shkrim-leximi Mediatik

# Hyrje

Barazia gjinore është trashëgimi civilizuese, respekti i së cilës është i rregulluar me ligjë. Mësuesit në Mal të Zi në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme janë të detyruar të përcjellin vlera të bazuara në respektimin e barazisë dhe barazisë gjinore. Neni 2 i Ligjit për Barazi Gjinore përcakton se *barazia gjinore nënkupton pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në të gjitha fushat e sektorit publik dhe privat, pozitë të barabartë dhe mundësi të barabarta për ushtrimin e të gjitha të drejtave dhe lirive dhe përdorimin e njohurive dhe aftësive personale për zhvillimin e shoqërisë, si dhe arritjen e përfitimeve të barabarta nga rezultatet e punës.*

Kontributi për barazinë gjinore përfshin luftën me të gjitha format e diskriminimit dhe trajtimit të pabarabartë që dallon midis burrave dhe grave dhe personave me seks dhe identitete të ndryshme gjinore.

Diskriminimi i drejtpërdrejtë për shkak të seksit nënkupton që një person trajtohet në mënyrë të pafavorshme në raport me një person tjetër në bazë të gjinisë. Barazia gjinore është parakusht për arritjen e demokracisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Një nga mënyrat më të rëndësishme në të cilën mësuesit dhe mësueset mund të lëvizin në dëshirën për të luftuar diskriminimin është zbulimi i stereotipeve dhe parimeve me të cilat funksionojnë stereotipet.

Ky proces bazohet në dyshimet e vlerës së marrëdhënieve tradicionale gjinore. Lindja e ati dyshimi kërkon gjithashtu bërjen e disa pyetjeve të rëndësishme:

- *Si mund të kontribuoj në trajtimin e barabartë të grave, burrave dhe njerëzve me seks dhe identitete të ndryshme gjinore në shoqëri?*
- *A është shteti i detyruar të sigurojë barazi për gratë, burrat dhe personat me seks dhe identitete të ndryshme gjinore në të gjitha sferat e jetës?*
- *Si mund të jetë shkolla vend ku zhvillohen mënyra të ndryshme për të luftuar diskriminimin?*

- *Pse unë, si dhe kolegët e mi, kemi nevojë për trajnime për barazinë gjinore në arsim?*
- *Si mund të shtoj përmbajtje në pjesën e lirë të kurrikulës që do të rezultojë në promovimin e barazisë midis burrave, grave dhe njerëzve me seks dhe identitete të ndryshme gjinore?*

Ky manual është krijuar në kuadër të projektit *TA PËRSHPEJTOJMË barazinë gjinore - nga stereotipizimi në barazi* të Qendrës për Arsimim Qytetar (QAQ), me mbështetjen e Ministrisë së Drejtësisë, të Drejtave të Njeriut dhe të Pakicave, dhe prezanton përgjigje entuziaste të neve që besojmë se mësuesit dhe mësueset kanë pushtet dhe mund të ndryshojnë të ardhmen duke ndikuar në ndërgjegjësimin e nxënësve për nevojën për të zhvilluar dhe promovuar barazinë gjinore.


Praktikumi ofron sërë zgjidhjesh/punëtorish të thjeshta dhe të lehta për tu zbatuar që do të interesojnë nxënësit dhe do të frymëzojnë mësuesit dhe mësueset.

Çdo punëtori është planifikuar të zgjasë 30 minuta. Koncepti metodologjik përfshin rezultate të duhura, materiale për punë, aktivitete në klasë me bashkangjitje të duhura. Megjithatë, duke pasur parasysh kreativitetin e kolegëve tanë, besojmë se puna jonë do të shërbejë si frymëzim për plotësimin dhe zhvillimin e përmbajtjeve të zbatueshme dhe interesante.

Besojmë gjithashtu se është thelbësore për *përsheptimin e barazisë gjinore* që të gjithë së bashku të marrim përgjegjësi dhe të kontribuojmë në respektimin e të drejtave të njeriut.



**Aventura vlen në vetvete**  
Amelia Earhart, aviatore



## Punëtori - Dalloj seksin dhe gjininë

**Rezultati:** Nxënësit dhe nxënëset njohin dallimin ndërmjet koncepteve të seksit dhe gjinisë

**Koha:** 30 minuta

**Materiali:** fletë pune, stilolapsa në dy ngjyra

### Aktivitetet në orë:

Mësuesi/ja u jep të gjithë nxënëseve dhe nxënësve fletë pune të fotokopjuar (*Bashkangjitja nr. 1*).


Kërkon që nxënësit të lidhin konceptet duke zgjedhur një nga dy opsionet e ofruara: *grua - burrë*.

Mësuesi/ja kërkon që nxënëset dhe nxënësit të shpjegojnë zgjedhjen e tyre. Pas shpjegimit, shtron pyetje që synon t'i ndërgjegjësojnë nxënëset dhe nxënësit se përvoja e tyre gjinore është diçka që u imponohet nga përvoja - bëhet fjalë për vlerat tradicionale të sugjeruara në familje, mjedisit të gjerë, përmes mediave, rrjeteve sociale apo në ndonjë mënyrë tjetër.

*Për shembull:* termin *trashëgimija* nxënëset dhe nxënësit zakonisht e lidhin me burrë, duke respektuar ligjin tradicional të pashkruar që pasuria dhe vlerat familjare trashëgohen nga pasardhësit meshkuj.

Detyra e mësuesit/ses është të thyejë besime të tilla dhe të theksojë rëndësinë e barazisë së pasardhësve dhe pasardhësve gjatë trashëgimisë së pasurisë familjare. Ky parim zbatohet në mënyrë konsistente kur shpjegohen të gjitha termat në bashkangjitjen e dhënë dhe së bashku me nxënëset dhe nxënësit, arrihet në përfundim se të gjitha termat u përkasin njëloj grave dhe burrave. E thënë thjesht, mësuesit/set u sugjerojnë nxënëseve dhe nxënësve se respektimi i traditës ndonjëherë nënkupton ruajtjen e trashëgimisë së vlefshme dhe ndonjëherë nënkupton dyshimin për ato aspekte tradicionale të jetës, ku zbatimi i vazhdueshëm mund të dëmtojë individin dhe individën ose një grup. Për të ilustruar shembuj të ndritshëm të traditës, e konsiderojmë të rëndësishme të theksojmë segmentet testamentare të autorit të *Shembujve të burrërisë dhe heroizmit* Marko Milanov - *Unë lë gjithçka nën kontroll të plotë të gruas sime Stefi, në mënyrë që askush të mos e kufizojë kurrë dhe sfidoj të drejtën e saj. Tani e autorizoj që të disponojë plotësisht me pronën tonë në favor të saj, pasi është meritë e saj që kemi fituar dhe ruajtur pronën... Në rast të vdekjes sime dhe nëse gruaja ime e ligjshme Stefa ka fatin të martohet me dikë tjetër, prona e përmendur këtu mbetet trashëgimi e saj dhe e fëmijëve të saj nëse Zoti e kënaq me të: të jetë ashtu siç e sheh mirë dhe dobishëm ajo. Kështu, tradita është gjithmonë më shumë se dëgjimi i verbër i besimeve të paraardhësve dhe parardhësve tanë.*

## Bashkangjitja 1



**Gruaja**



**Burri**

Trashëgimia	Seksi më i fortë	Makinë sportive	Shopping
Kapele	Teknologjitë informative	Politika	Biznes
Gatimi	Inxhinieri elektrike	Model flokësh	Lotë
Pushkët dhe makinat	Kukulla	Xhinse	Vresht
Bluzë rozë	Të ushqejë dhe të kujdeset	Rruajtja	Jaht
Kryefamiljari	Sukses sportiv	Kirurgji estetike	Tradhti bashkëshortore
Vathët	Vozitje me kanotazh	Parfum	Fuqi
Politika		Birrë	Tatuazh
Fundi		Ngjyrë për flokë	Dhimbje

### TANI E DI!





**Seksi** nënkupton dallimet biologjike midis grave dhe burrave. Këto dallime janë kryesisht të përhershme dhe universale.

**Gjinia** nënkupton rolet e grave dhe burrave që shoqëria iu ka caktuar. Opinionet, qëndrimet dhe sjelljet ndaj gjinisë mësohen dhe mund të ndryshojnë.

Dallimet e seksit dhe gjinisë janë veçanërisht të rëndësishme kur kemi parasysh çështjen e dallimit të identitetit gjinor, e cila do të diskutohet në faqet në vijim. Jemi të sigurt se është shumë e lehtë ti tërheqësh vëmendjen nxënësve dhe nxënësve për faktin se seksi i përket natyrës, ndërsa gjinia i përket shoqërisë. Injorimi i këtyre aspekteve reale do të thotë të kontribuosh në shkeljet e drejtave të njeriut. Me këtë punëtori të thjeshtë mund të tërhiqni vëmendjen për rëndësinë e *përshpejtimt të barazisë*.

**Askush nuk mund të më thotë se çfarë mund dhe çfarë nuk mund!**

Amna El Hadad – peshëngritëse



## Punëtori - Rolet gjinore

**Rezultati:** Nxënëset dhe nxënësit krahasojnë dhe shpjegojnë rolet gjinore.

**Koha:** 30 minuta

**Materiali:** fletë pune

**Aktivitetet në orë:**

Këtë punëtori mund ta realizoni duke punuar në çifte. Çdo çift në klasë fiton një listë me punë të shtëpisë. Nga nxënësja dhe nxënësi duhet t'u kërkohet të klasifikojnë punët e kryera nga gratë ose burrat ose punët e kryera edhe nga gratë edhe nga burrat.



### Punët e shtëpisë

Larja e rrobave

Riparimi i prizës

Vendosja e tryezës për ushqim

Gatimi

Luajtja me fëmi

Riparimi i makinës

Hekurosje

Furnizimi me karburant

Marrja e fëmijëve në shëtitje

Montimi i pajisjeve shtëpiake

Hedhja e mbeturinave

Shkuarja në treg

Pastrimi i dritareve

Fshirja me fshesë me korrent

Lyerja e murit

Blerja e rrobave për fëmijë

Pastrimi i tryezës pas ngrënies

Të ushqyerit e fëmijëve

Ndihmë me detyrat e shtëpisë

Mirëmbajtja e bimëve në shtëpi

Pushim mjeksor kur një fëmijë është i sëmurë

Kujdesi për anëtarët e vjetër të familjes

Ndërrimi i llambës

Bërja e ëmbëlsirave

Pastrimi i pluhurit

Përcjellja e fëmijëve në kopsht/shkollë

Pas renditjes së punëve të shtëpisë, nxënëset dhe nxënësit duhet t'u përgjigjen pyetjeve dhe urdhrave të punës në vazhdim:

- Shkruani të paktën tre aktivitete nga lista e punëve të shtëpisë që kryhen çdo ditë.
- Shkruani të paktën tre aktivitete nga lista e punëve që kryhen periodikisht.
- Kush bën më shumë aktivitete të përditshme dhe periodike në shtëpi?
- Shkruani të paktën pesë aktivitete ku merrni pjesë vetë në kryerjen e tyre.
- Dalloni dhe shpjegoni nëse ka ndonjë ndryshim midis punëve të shtëpisë në të cilat marrin pjesë vajzat dhe djemtë.
- A është e natyrshme apo e imponuar ndarja e punëve të shtëpisë?
- Kush dhe si i imponon rolet gjinore grave dhe burrave?
- Sa kohë duhet gjatë ditës për të kryer punët e shtëpisë?
- Si ndikon kjo ndarje e punëve tek gratë e punësuarat?
- Kush ka më shumë kohë të lirë dhe mundësi për t'iu kushtuar interesave personale?
- Kush mund të fitojë më shumë të ardhura duke kryer punë të ndryshme?

## TANI E DI!

**I Rolet gjinore** janë role të cilat u ndahen burrave dhe grave. Rolet gjinore nuk jepen në bazë të aftësive dhe shkathtësive.


**Tradita** imponon atribuimin e roleve të caktuara për gruan, gjegjësisht për burrin.

Për gratë, punët e shtëpisë synohen tradicionalisht, dhe për burrat, punët e rëndësishme që kryhen jashtë shtëpisë. Kështu, puna e papaguar tradicionalisht i takon gruas dhe burrit puna që sjell fitim. Me kalimin e kohës, gratë kanë fituar të drejtën për t'u punësuar, por edhe detyrimin për t'u ngarkuar dyfish - në shtëpi dhe në punë.

Ndarja tradicionale e roleve gjinore nuk e lejon gruan të bëjë hap të rëndësishëm përpara në drejtim të arritjes së barazisë, ndaj është e nevojshme të braktisen besimet ekzistuese. Ndarja radikale dhe e ngurtë e roleve gjinore është veçanërisht e theksuar në kohë kur ka pasiguri të gjithanshme. Çështja e barazisë gjinore shpesh marginalizohet për të pritur "kohë më të mira". Megjithatë, në shkollë ka shumë dëshmitare dhe dëshmitarë që aktet juridike pohuese nuk mund të kontribuojnë sa duhet në pozitën e grave, por është e nevojshme të ndikohet tek fëmijët dhe të rinjtë dhe të inkurajohet nevoja e tyre për të ndryshuar realitetin.

**Edhe vajzat mund të jenë heroina**

Xheni Vang, astronome



## Punëtori - Stereotipet

**Rezultati:** Nxënëset dhe nxënësit njohin dhe shpjegojnë termin e stereotipit

**Koha:** 30 minuta

**Materiali:** tre hamer letra, post-it ngjitëse, stilolapsa, flomastera...

**Aktivitetet në orë:**

Realizimi i kësaj punëtorie nënkupton ndarjen e nxënësve dhe nxënësve në tri grupe. Secili grup fiton detyrë me synim të nxjerrë përfundim për imponimin e shumë stereotipeve në procesin e të mësuarit të roleve gjinore.



**Grupi i parë** - pjesëtarët dhe pjesëtarët e këtij grupi shkruajnë në post-it ngjitëset lodrat tipike për vajza dhe lodrat tipike për djem.



**Grupi i dytë** - pjesëtarët dhe pjesëtarët e këtij grupi shkruajnë në post-it ngjitëset sportet tipike për vajza, dhe sportet tipike tipike për djem.



**Grupi i tretë** - pjesëtarët dhe pjesëtarët e këtij grupi shkruajnë në post-it ngjitëset emrat e heroinave të filmave të animuar në rrobat dhe sendet që prindërit/kujdestarët zakonisht blejnë për vajzat dhe djemtë.

Pas renditjes dhe ngjitjes në hamer, mësuesi/sja bën pyetje të ngjashme me pyetjet e sugjeruara:

**Grupi i parë:**

- Mbi çfarë jeni bazuar që kukullat Barbie janë lodra tipike për vajzat?
- Çfarë ju bën të zgjidhni makinat si lodra tipike për djemtë?
- A mund të jepni shembull të një ndarje të ndryshme lodrash?
- Kush i zgjedh lodrat dhe i'a ofron fëmijëve?
- A kanë fëmijët e vegjël një ndikim vendimtar në këtë zgjedhje?



- A keni dëshiruar ndonjëherë që të keni lodër që është mbase e ndaluar për ty si vajzë apo si djalë?

#### Grupi i dytë:

- Mbi cilën bazë keni arritur në përfundimin se një sport është më i përshtatshëm për vajzat/djemtë?
- A ishte e lehtë të gjeni sporte tipike për femra?
- A ishte e lehtë të gjeni sporte tipike për meshkuj?
- Sa sportistë të suksesshëm përfaqësohen në media dhe sa sportiste të suksesshëme?
- Si ndikon një përfaqësim i tillë në përvojën tuaj dhe paracaktimin e sportit për njërin nga sekset?
- A e dëgjoni më shpesh zërin e mashkullit apo të femrës kur shikoni përmbajtje sportive dhe pse?

#### Grupi i tretë:

- Kush i zgjedh rrobat për vajza apo djem?
- Cilat janë ngjyrat standarde të rrobave për vajzat dhe cilat për djemtë?
- Cili është qëllimi i prodhuesit të rrobave të tilla të dizajnuara?
- A mund të vendosin vetë fëmijët e vegjël se cilët janë heroinat e tyre të preferuara të filmave të animuar dhe heronjtë e tyre të preferuar të filmave të animuar?
- A mund të jepni një shembull të takimit me vajzë të veshur me bluzë me imazhin e Njeriut Marimange (Spider-Man), ose djalë që ka veshur bluzë me imazhin e Elsës?
- A janë fëmijët të veshur kështu në shërbim të të ushqyerit dhe reklamimit të një stereotipi të caktuar?

#### TANI E DI!

**I Stereotipi** është opinion i vendosur, parabindje dhe përgjithësim i veçorive të caktuara që i atribuohen dikujt ose diçkaje.


**I Paragjykimi** është mendim, besim ose përfundim i paramenduar për dikë ose diçka për të cilën nuk dimë sa duhet.

**Stereotipet gjinore** janë modele të mësuara sociale dhe kulturore, opinione dhe sjellje sipas të cilave grave dhe burrave u atribuohen karakteristika dhe role të përcaktuara në bazë të seksit të tyre. Ato janë pasojë e vlerave, qëndrimeve, normave dhe paragjykimeve të rrënjosura. Stereotipet gjinore shërbejnë për të justifikuar dhe përjetësuar marrëdhëniet tradicionale ku burrat kanë epërsi ndaj grave.

Stereotipet dhe paragjykimet janë prindërit e diskriminimit. Ata kujdesen mirë për të. Diskriminimi shoqërohet shpesh me gjuhën e urrejtjes dhe forma të tjera të sjelljes sociale të papranueshme. Racizmi, ejxhizmi dhe homofobia bazohen në ndjenja, opinione dhe sjellje që nuk mund të kenë argumentacion të fortë. Prandaj, është e nevojshme të inkurajohen nxënëset dhe nxënësit të bëjnë pyetje, të kontrollojnë se si kanë fituar besime të caktuara, të flasin me zë të lartë për grupet vulnerabel dhe të zhvillojnë strategji për të mbrojtur gratë, fëmijët, të moshuarit, personat LGBTQ dhe të tjerët.

**Fëmijëve u duhet mësuar pavarësia dhe vetë-mjaftueshmëria**

Maria Montesori, fizikane dhe pedagoge



## Punëtori - Stereotipet në përralla

**Rezultati:** Nxënëset dhe nxënësit diskutojnë praninë e stereotipeve në përralla dhe nxjerrin përfundime rreth mënyrave të pranimit të stereotipeve

**Koha:** 30 minuta

**Materiale:** letër dhe stilolaps / kompjuter

### Aktivitetet në orë

Mësueset dhe mësuesit e fillojnë këtë punëtori duke bërë pyetjet në vazhdim:

- Në cilën moshë janë njerëzit më të ekspozuar ndaj përmbajtjes së përrallës?
- Cila është përralla e jote e preferuar dhe pse?
- A ka më shumë protagoniste apo protagonistë në përralla?
- Kujt i caktohet më shpesh roli i viktimës dhe kujt roli i shpëtuesit?
- Jep shembuj të personazheve negative. Çfarë gjinie janë personazhet negative në përralla?
- Çka nuk ju ka pëlqyer në përralla?
- A kanë përrallat potencial të zhvillojnë paragjykime?

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në gjashtë grupe me numër të përafërt anëtarësh/resh dhe kërkon të rikrijojnë përralla të njohura ndërkombëtare, duke nisur nga titulli, duke zëvendësuar personazhet femra dhe meshkuj të përrallës.

**Grupi i parë - Hirushja.** Pritet që duke u nisur nga titulli, përralla të quhet *Hirushi*. Personazhi kryesor jeton me nënën e tij dhe së shpejti atyre u bashkohen njerku dhe dy djemtë e tij. Hirushi detyrohet të bëjë të gjitha punët e shtëpisë, të shkojë në ballo vetëm me ndihmën e elfit të



mirë dhe të kthehet para mesnatës. Një princeshë e bukur dhe e pasur zgjedh princin midis të gjithë të rinjve të disponueshëm në mbretëri. Vullneti i saj mund të shpëtojë princin nga vuajtja e përjetshme dhe jetës në mëshirën e njerkut dhe djemve të tij ...

**Grupi i dytë** - *Borëbardha dhe shtatë xhuxhat* (Borëbardhi dhe shtatë xhuxha)

**Grupi i tretë** - *Bukuroshja e fjetur* (Bukuroshi i fjetur)

**Grupi i katërt** - *Rapanzëll* (Rapanzelli)

**Grupi i pestë** - *E bukura dhe bisha* (I bukuri dhe bisha)

**Grupi i gjashtë** - *Sirena e vogël* (Sireni i vogël)

Duke marrë parasysh përmbajtjen e përrallës, mësuesi/ja shtron pyetjet në vazhdim:

- Si ndiheni për ndryshimin e emrave dhe roleve gjinore të personazheve kryesorë?
- Çfarë është e pazakontë për princat dhe çfarë është e pazakontë për princeshat?
- Si duken burrat në rolin e princave të pafuqishëm që mund të shpëtohen nga vullneti i mirë i një gruaje?
- Pse roli i zuzarit më së shpeshti i atribuohet një femre, pra në përralla janë shtriga, njerka të këqija, forca madhërore që pengojnë lumturinë dhe suksesin e personazheve kryesorë?
- Rendisni përralla apo filma të animuar në të cilët fati i personazhit kryesor thyen stereotipet?

## TANI E DI!

**Emancipimi i grave** nënkupton sigurimin e zhvillimit dhe avancimit të plotë të pozitës së grave në të gjitha fushat, veçanërisht në sferën politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Në këtë mënyrë, emancipimi garanton realizimin dhe gëzimin e barazisë me burrat.



Termi i emancipimit kërkon ndryshim në modelet sociale dhe kulturore të sjelljes. Për sa i përket sjelljes së burrave dhe grave, është e dukshme prania e inferioritetit femëror, pra epërsisë mashkullore. Prandaj, arritja e barazisë gjinore është çështje kyçe sociale dhe kulturore.

Përrallat janë pjesë e rëndësishme e rritjes të çdo fëmije. Megjithatë, në përralla ka një sërë detajesh që kërkojnë vëmendje të veçantë. Në të gjitha përrallat, martesë është një lloj shpërblimi për ato gra që tregojnë guxim, vendosmëri, këmbëngulje. Edhe pse kanë shumë virtyte që tregohen drejtpërdrejt, gratë tregohen ose si viktime (Hirushja, Borëbardha, Bukuroshja e Fjetur, Rapanzëll, Sirena e Vogël) ose si njerka, motra të këqija, shtriga (Kruela, Ursula, Malefika). Rishikimi analitik i përrallave duhet të rezultojë në zhvillimin e aftësisë së nxënësve dhe nxënësve për të menduar në mënyrë kritike për të gjithë përmbajtjet që arrijn tek ata, qoftë literaturë tekstesh apo videoklipe në rrjetet sociale si Instagram apo Tik-Tok.



## Gjithmonë e dija se do të udhëtoja në kozmos

Mej K. Jemison, astronaute dhe mjekë



## Punëtori - Diskriminimi gjinor

**Rezultati:** Nxënëset dhe nxënësit zbulojnë dhe vlerësojnë praninë e diskriminimit gjinor në jetën e përditshme

**Koha:** 30 minuta

**Materiali:** material i printuar i paraqitur në formë të fletës për punë

### Aktivitetet në orë:

Mësuesi/ja i ndan nxënësit në tre grupe me numër afërsisht të njëjtë anëtarësh.

Nga nxënëset dhe nxënësit pritet të lexojnë me kujdes përmbajtjen e fletës së punës që u është ofruar më parë dhe të zgjidhin pretendimet në bazë të kërkesave që u janë bërë në fletën e punës.



## Përmbajtja 2

### Renditni thëniet e mëposhtme në varësi a i përkasin gjinisë apo seksit:

Femrat janë seksi më i butë.

Meshkujt nuk bëjnë lindje.

Femra është shtylla e familjes.

Vajzat janë më të rregullta se meshkujt.

Në Egjiptin e lashtë, femrat trashëguan të gjithë pronën, jo meshkujt.

Femrat kanë cikël menstrual.

Meshkujt kanë prostatë.

Femrat gatojnë më mirë.


Meshkujt janë me leshatakë.

Femrat janë shofere të këqija.

## Përmbajtja 3

**Listo pabarazitë midis grave dhe burrave në:**

Sport	Arsim
Ambient pune	Sferën e sigurisë
Gjuhë	Art
Botë të politikës	Mjedis familjar
Shëndet	Mjedis shkollor



## Përmbajtja 4

**Rendit tiparet dhe përgjegjësitë e mëposhtme sipas faktit nëse ato u përkasin grave apo burrave:**

Forca, bukuria, dobësia, ndjeshmëria, ambicia  
 Butësi, pavarësi, vetëbesim, luftim  
 Durim, autoritet, sukses në biznes, qëndrueshmëri  
 Impulsivitet, ftohtësi, modestancë, tolerancë



Përfaqësuesja/si i/e grupit shpall përfundimet. Mësuesja/si u jep sugjerime që synojnë pa mëdyshje luftimin e diskriminimit gjinor dhe në atë mënyrë u ofron një këndvështrim të ndryshëm në lidhje me barazinë gjinore.

### TANI E DI!


**Diskriminimi gjinor** është çdo dallim, përjashtim ose mohim i grave bazuar në seksin e tyre. Pasoja e diskriminimit gjinor është rrezikimi ose pengimi i arritjes së barazisë ndërmjet grave dhe burrave.

**Socializimi gjinor** - vajzave dhe djemëve u imponohet se si do të mendojnë dhe të sillen në varësi të mesazheve që kanë marrë si fëmijë. Të dy pranojnë modele të imponuara, duke pranuar diskriminimin gjinor si parim të vlefshëm brenda familjes dhe mjedisit më të gjerë. Në procesin e socializimit gjinor, më së shpeshti janë të pranishme mesazhet seksiste, të cilat formojnë vlerat dhe rregullat bazë për vajzat dhe djemtë që do të bëhen gra dhe burra.

Për të mbajtur pozicion pushteti në raport me gratë, shpesh do të dëgjoni se pozita e gruas ka ndryshuar ndjeshëm dhe se jemi afër barazisë. Ndonjëherë këtij qëndrimi i bashkohet vajtimi për ditët e mira të shkuara. Megjithatë, anashkalohet fakti se pas shekujsh nënshtrimi nuk mjafton të flitet për barazi formale, por duhet vepruar. Me arsim, nxënëset dhe nxënësit ndërgjegjësohen se detyra e tyre është të krijojnë marrëdhënie shoqërore që do të ofrojnë trajtim të barabartë për të gjithë, trajtim të barabartë kudo dhe trajtim të barabartë gjithmonë.

**Ta dinë të gjithë brezat se gratë me uniformë u kanë dhënë lirinë**

Meri Edvards Valker, kirurge



## Punëtori – Ta njoftojmë seksizmin

